



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur në Klinë më datë 10.03.2023, ndërmjet :

1. Komunës së Klinës, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, në tekstin vijues Komuna;
2. Kishës Protestante “ Kisha Rilindja e Kosovës, të cilën e përfaqëson, Pastori Jeton Sokoli, në tekstin vijues Kisha.

Neni 1

Qëllimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për qëllim angazhimin e përbashkët në realizimin e projektit “ Klinika Falas më Mjekë nga Amerika”, që planifikohet të mbahet më datat **16-17 Maj 2023**, në Klinë.

Neni 2

Obligimet e Komunës

- 2.1 Komuna e Klinës do të siguroj e vë në dispozicion hapësirat e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare – “Nënë Tereza”.
- 2.2 Komuna e Klinës, nëpërmjet Drejtorisë së Shëndetësisë do siguroj tre (3) staf mjekësore nga Klina që do bashkëpunojnë për së afërmi me mjekët nga Amerika.
- 2.3 Qendra e Mjekësisë familjare “Nënë Tereza” do bëj gjitha përgatitjet e duhura që hapësirat e mjaftueshme për realizimin e këtij projekti të jeni gati dhe në dispozicion.

Neni 3

Obligimet e Kishës

3.1. Organizimin e sjelljes së stafit mjekësore nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës , përmes organizatës Operation Renewed Hope.

3.2 Kisha do bashkëpunoje ngushtë në organizimin sa më profesional të projektit, bashkë me Drejtorinë e Shëndetësisë në Klinë.

3.3 Kisha merr përsipër organizimin infrastrukturor të projektit, mirëmbajtjen , sigurimin e përthyesve profesionistë si dhe lirin me kohë të qendrës.

Neni 4

Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lire të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë në përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.


PALËT

Zenun Elezaj



Kryetari i Komunës së Klinës

Jeton Sokoli



Pastor i Kishës Rilindja e Kosovës.